

bredalorett.com



KIT RROTE



KUSHINETAT E RROTËS JANË PREJ VITESH NJË NGA PRODUKTET MË TË RËNDËSISHME TË GAMËS SONË.

- Kryesisht të shpërndara në kite, janë pjesë shumë të kërkuar në automjete, për shkak të kushteve delikate ku ato kryejnë funksionin e tyre. Ne në Breda Lorett, jemi të kujdeshëm të sigurojmë besueshmërinë dhe cilësinë duke shqyrtuar në detaje çdo element që i karakterizon.

- Ashtu si shumica e prodhuesve të pjesëve, ne nuk i prodhojmë kushinetat në fabrikë. Nga ana tjeter kemi një përvojë të gjatë në fushën e masave dhe karakteristikave teknike që synojnë të optimizojnë performancat, e kombinuar me një njohje të përgjithshme të produktit. Përveç kësaj, i zgjedhim furnizuesit tanë me reptësi duke i nënshtuar ndaj verifikimeve sistematike të cilësisë.


- Ndjekim me kujdes standartet ISO në cdo procedurë biznesi, si udhërrëfyes dhe referencë për hartimin e qartë të të gjitha atyre dokumenteve (të tillë si planet e kolaudimit) të nevojshme, për të verifikuar që proceset prodhuese dhe dokumentet e specifikimeve të prodhimit dhe furnizimit në fabrika të ndryshme, të jenë në cilësinë e kërkuar. Besueshmëria e produkteve që përfshihen në paketat tona, është e garantuar.





- KUSHINETA RROTË ËSHTË NJË ELEMENT THELBËSOR I SIGURISË QË MBAN NGARKESAT AKSIALE DHE RADIALE NË KUSHTE SHUMË TË NDRYSHME VIBRIMI DHE TENSIONI, NË KUSHTET MË TË LARMISHME MJEDISORE.

RREZIKU QË MUND TË REZULTOJË NË RAST KEQFUNKSIONIMI TË KUSHINETËS, BËN TË DETYRUESHËM ZHVILIMIN E NJË PROGRAMI PËRMIRËSIMI TË VAZHDUESHËM TË CILËSISË SË KOMPONENTËVE TË BRENDSHËM, PËR TA BËRË GJITHMONË TË BESUESHËM PRODUKTIN FINAL.



- Ne ndërhymë menjëherë në çdo aspekt teknik të produktit dhe bëjmë të jetë në përputhje me furnizuesit tanë të zgjedhur dhe me të gjitha specifikat, për të arritur një standard të lartë cilësie.


Kontrollojmë në mënyrë rigoroze çdo detaj sepse gjëra si xhokot, grasoja, mburojat, kuotat e punës dhe tolerancat, janë të gjitha elemente që lejojnë të përshtatësh kushinetën në aplikime të ndryshme dhe të ndikosh në mënyrë drastike në jetëgjatësinë e funksionimit të saj.



- Në të njëjtën mënyrë, njojuritë teknike dhe instrumente të veçanta matjesh lejojnë verifikimin e kushinetave dhe përputhshmërinë e tyre me standartet në sistemin e shpërndarjes, si edhe bërjen e modifikimeve që përmirësojnë karakteristikat.

SOT GAMA
JONË
PËRBËHET
NGA MË
SHUMË SE
1700
REFERENCA
DHE RRITET NË
FUNKSION
TË EVOLUIMIT
TË PARKUT
TË AUTOMJETEVE.

• **SHEMBULL I KUSHINETËS RROTË
DHE I PËRBËRËSVE ME KARAKTERISTIKA TË VEÇANTA**



Të gjitha produktet e gamës sonë kontribuojnë në popullimin e bazës së të dhënavë "TecDoc", nga e cila vijnë direkt shumë nga sistemet më të zakonshme të kërkimit të kodeve dhe "e-commerce"-it të të gjithë zinxhirit të shpërndarjeve të pjesëve të këmbimit.

